



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Njoftim Paraprak Përqendrimi

Rasti: Përfitim Kontrolli: Persona Fizik Z.Grigor Joti & Z. Plarent Kristo / InRE SHPK

Me shkresën Nr.82, datë 01.02.2018, “Shkresë përcjellëse”, Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me përqendrimin e realizuar në bazë të “Kontratë për Shitblerje të Kuotave të Kapitalit” firmosur në datë 03.01.2018. Nëpërmjet këtij transaksioni synohet përfitimi i kontrollit të shoqërisë InRE SHPK (“Target”) nga Z. Grigor Joti dhe Z. Plarent Kristo (“Blerësit”).

Personat Fizik Z.Grigor Joti dhe Z.Plarent Kristo, përfitojnë kontrollin e drejtpërdrejtë nëpërmjet blerjes së kuotave të shoqërisë InRE SHPK, respektivisht 70% dhe 30% të zotëruara më parë nga ortaku i vetëm Znj.Arjana Noçka.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

InRE SHPK, Shitësi/Target është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NUIS L62323016Q, me adresë në Rrugën Abdi Toptani, Torre Drin, Kati1, Tiranë. Objekt i veprimtarisë së shoqërisë target InRE SHPK janë aktivitete të marrjes dhe dhënies me qira të pasurive të paluajtshme. Shitje, blerje, administrim, rikonstruksion të ndërtesave, hoteleve, qendrave rezidenciale, tregtare, administrative dhe turistike si dhe kryerjen e shërbimeve të ndryshme në to, si për shembull, por duke mos u kufizuar në: shërbime tregtare, reklama, argëtim, etj. Investime në fushën e ndërtimit, studimit dhe projektimit të objekteve të mësipërme, etj. Administrim të bashkëpronësisë. Import, eksport të të gjitha impianteve, pajisjeve, elementeve të ndërtimit si dhe çdo veprimtari të lidhur me aktivitetet e mësipërme. Import, eksport të produkteve të ndryshme industriale, etj.

Z.Grigor Joti (Blerësi 1), person fizik, i cili kontrollon në mënyrë direkte dhe/ose indirekte shoqëri të tjera si InveG SHPK, Investment Joti-Infosoft Group SHPK, etj. Investment Joti-Infosoft Group SHPK, zotëron pjesë të kapitalit themeltar në disa shoqëri, kryesisht në fushën e teknologjisë së informacionit dhe distribucionit të produkteve ushqimore dhe pastrimit, etj.

Z.Plarent Kristo (Blerësi 2), person fizik, është aksionar (me më pak se 50%), në shoqëri në të cilat është aksionar në mënyrë direkte dhe/ose indirekte Z. G. Joti.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.